



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI I BASHKIAK
PUKË

Nr. 2299 / Prot.

Pukë, më 17.12.2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit bashkiak Pukë.

Antarëve të Këshillit të Bashkisë Pukë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 5 datë 17.12.2024, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë do të zhvillohet me datën **27.12.2024**, ora **11⁰⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 03.12.2024
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Tetor 2024**.
3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Nentor 2024**.
4. Projekt-vendim : " Per shtyrjen e afatit të planit social të Bashkisë Pukë 2021-2023 deri në miratimin e planit të ri social 2025-2028"
5. Projekt-vendim " Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetin vjetor për vitin 2025"
6. Projekt -Vendim : " Per disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr. 56 date 30.12.2022 " Per miratimin e paketës fiskale 2023"(i ndryshuar)
7. Projekt - vendim " Për një shtesë në VKB nr 6 date datë 09. 02.2024 " Për miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor të një sipërfaqe pyjore publike prej 6.65 Ha në ekonominë pyjore Kryezi -Bicaj për ndërtim kanali dhe shtrirje tubacioni uji nga subjekti "Uji Puka"
8. Projekt Vendim " Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqe pyjore prej 11 Ha për qellime pushimi, argëtimi, shëndetësore, turistike, sportive dhe kulturore" në parcelën, nr. 93/a dhe 101/a të ekonomisë pyjore Krrab-Bushat"
9. Projekt-Vendim " Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave profesionale për vitin shkollor 2024-2025"

10. Projekt-Vendim “ Për trajtimin me bursë të nxënësve të akomoduar në konviktin “Ali Bytyçi” për vitin shkollor 2024-2025”

11. Projekt-Vendim “ Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendor të nderit në Bashkinë Pukë”

12. Projekt-Vendim “ Për miratimin e rregullores së komisionit këshillimor “ Për titujt vendor të nderit , kriteret dhe procedurën e dhenies së tyre , si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve , institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”

13. Projekt-vendime : Për vleresim me tituj nderi për personat si me poshtë:

Zj. Kristina Marku, z. Ekrem Bardha (shtetas shqiptaro-amerikan), z. Marash Nicu'aj(shtetas shqiptaro-amerikan), zj. Anjeza (Ndoj) Gjonaj, Z. Daniel Carmody(shtetas amerikan), zj. Joli Agolli Paporisto(shtetas shqiptaro-amerikan), z. Mark Nikolle Lulgjuraj(shtetas shqiptaro-amerikan), z. Ndue Ftoni (shtetas shqiptaro-amerikan), Z. Gjovalin Lumaj(shtetas shqiptaro-amerikan) dhe z. Vehbi Bajrami .

14. Të tjera.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 18.12.2024 , nga ora 08-³⁰ deri ne oren 13⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Duke ju falenderuar për mirekuptimin dhe bashkëpunim, ju lutem konfirmoni pjesemarrjen ne mbledhje!

SEKRETARI

Hazbi TERBUNI

